

VENDIM
Nr. 41, datë 24.11.2016

PËR REFUZIMIN E KËRKESËS PËR ANËTARËSIM NË SKEMËN E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE TË SHOQËRISË SË KURSIM-KREDITIT “PINARË”

Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, në mbështetje të nenit 4, shkronja “a”, të nenit 23, të nenit 25, të nenit 26, pika 3, të nenit 27, të nenit 34, pika 1, të nenit 52, pika 1, shkronja “p” dhe pika 2, të nenit 53, pika 5, shkronja “d”, të nenit 68, pika 1/2, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 35, pika 4, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, si dhe të nenit 5, nenit 6, pika 5 dhe pika 8, si dhe të nenit 41, pika 1, shkronja “b”, të udhëzimit nr. 4188, datë 1.9.2016, “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”, pasi u njoh me relacionin e drejtorit të përgjithshëm mbi përmbushjen e kushteve nga shoqëria e kursim-kreditit “Pinarë”,

VËREN SE:

1. Periudha tranzitore për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe certifikatës së sigurimit të depozitave përfundon në datën 30 nëntor 2016.

2. Shoqëria e kursim-kreditit “Pinarë” ka paraqitur kërkesën për anëtarësim në skemën e sigurimit të depozitave dhe në datë 14 korrik 2016, grupi i punës i përbërë nga punonjës të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Bankës së Shqipërisë kreu verifikimin për plotësimin e kushteve nga kjo shoqëri.

3. Nga verifikimi i përbashkët u konstatua se shoqëria e kursim-kreditit “Pinarë”:

a) nuk paraqiti asnjë dokumentacion të kërkuar sipas programit të verifikimit apo të kërkuara gjatë procesit të verifikimit mbi depozitat dhe depozituesit, drejtimin e shoqërisë ose gjendjen financiare;

b) mungonte sistemi informatik për mbajtjen e të dhënave, raportimin e tyre dhe përlllogaritjen e primit;

c) ambjentet e ushtrimit të veprimtarisë nuk ishin të përshtatshme dhe nuk përmbushnin kushtet e sigurisë fizike për zhvillimin e veprimtarive financiare dhe përpunimin e shumave monetare;

ç) mungonte moduli i kontabilitetit;

d) mungonte stafi i punësuar dhe Këshilli Drejtues dhe Asambleja e Përgjithshme nuk kishin kryer asnjë mbledhje gjatë vitit 2016;

dh) komiteti i kontrollit nuk kishte kryer asnjë veprim mbi aktivitetin e shoqërisë.

4. Nisur nga gjetjet e verifikimit të datës 14 korrik 2016, Banka e Shqipërisë me shkresën nr. prot. 5173, datë 3.10.2016, “Mbi marrjen e masave mbikëqyrëse për shkeljen e akteve ligjore dhe nënligjore nga Shoqëria e Kursim-Kreditit “Pinarë””, vendosi të pezullojë aktivitetin kredidhënës dhe depozitues të këtij subjekti.

Bazuar në sa më sipër, Këshilli Drejtues,

VENDOSI:

1. Shoqëria e kursim-kreditit “Pinarë” nuk përmbush kushtet për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe të certifikatës së sigurimit të depozitave.

2. Refuzimin e kërkesës për anëtarësim në Skemën e Sigurimit të Depozitave të shoqërisë së kursim-kreditit “Pinarë”.

3. Të informohet Autoriteti Mbikëqyrës mbi këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet shoqërisë së kursim-kreditit “Pinarë” brenda 7 ditëve kalendarike nga miratimi i tij.

KRYETAR
Donald Duraj